



ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

RAPORT GJASHTËMUJOR

**MBI ZBATIMIN E PLANIT STRATEGJIK DHE PLANIT TË
VEPRIMIT PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË**

JANAR –QERSHOR 2025

HYRJE

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka hartuar planin strategjik 2023-2025 në vijim të planit strategjik 2020-2022, me vizionin dhe misionin për sa më shumë përgjegjshmëri dhe vendosmëri në prioritetet e punës për dy vitet në vijim.

Zhvillimi i planit strategjik do të fokusohet drejt një dimension tjetër, në atë të konsolidimit të përvojës me sfida të reja dhe fuqizimit të mëtejshëm të kapaciteteve për të arritur efekte domethënëse të performancës profesionale dhe institucionale, konkretisht:

- Krijimit të një sistemi të plotë dhe afatgjatë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor;
- Matjes së performancës së magjistratëve, gjyqtarë/prokurorë, lidhur me cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë;
- Forcimit të mekanizmave institucionalë për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të subjekteve të procedimit disiplinor;
- Krijimit të sistemit të teknologjisë së informacionit për menaxhimin e çështjeve dhe përmirësimin në vijimësi të kësaj infrastrukture;
- Rritjes së kapaciteteve të inspektorëve nëpërmjet praktikave të trajnimit dhe inspektimit me homologët evropianë;
- Kryerjes së inspektimeve të vazhdueshme tematike dhe institucionale të planifikuara, në zbatim të metodologjisë dhe standardeve përkatëse.

Zbatimi i planit strategjik dhe planit të veprimit 2023-2025 sigurohet nëpërmjet një sistemi monitorimi dhe vlerësimi lidhur me zbatimin e objektivave, masave apo aktiviteteve të planifikuara.

Raportimi i zbatimit të planit të veprimit realizohet në baza periodike 6 – mujore, bazuar në raportet e strukturave (njësive organizative) të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, lidhur me zbatimin e objektivave.

Procesi i monitorimit dhe i vlerësimit do të realizohet nga ana e strukturave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet monitorimit në vazhdimësi të nivelit të zbatimit të planit strategjik në përputhje me afatet e parashikuara në planin e veprimit; raportimin periodik mbi nivelin e zbatimit të secilit aktivitet/masë sipas fushës së veprimtarisë së secilës njësi organizative të Zyrës së ILD; bashkërendimin e aktiviteteve dhe strukturave përkatëse në rastet e vonesave apo mos zhvillimit të aktiviteteve të planifikuara, si dhe harmonizimin me dokumentet e tjerë strategjik dhe burimet financiare të parashikuara për periudhën 2023-2025, nëpërmjet monitorimit në vazhdimësi të:

- nivelit të zbatimit të planit strategjik, sipas afateve të parashikuara në planin e veprimit;

- raportimit periodik të secilit aktivitet apo masë sipas fushës së veprimtarisë së secilës njësi organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- bashkërendimin e aktiviteteve dhe strukturave përkatëse në rastet e vonesave apo mos zhvillimit të atyre të planifikuara;
- harmonizimin me dokumentet e tjerë strategjikë dhe burimet financiare të parashikuara për periudhën 2023-2025.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka për mision forcimin e mekanizmave institucionalë në matjen e performancës së sistemit, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë së subjekteve të hetimit disiplinor në ushtrimin e detyrës nga njëra anë dhe motivimin e rritjen e besimit të publikut dhe organeve që ligji u njeh të drejtën e paraqitjes së ankesave, ndaj sistemit gjyqësor, nga ana tjetër.

Objektivat prioritare të vendosura në strategjinë dhe planin strategjik 2023-2025, do të kontribuojnë në konsolidimin dhe fuqizimin e funksioneve dhe objektivave të punës së institucionit duke u orientuar drejt efikasitetit funksional, bashkëpunimit dhe koordinimit midis njësive të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Plani strategjik dhe qëllimet strategjike gjenden të përcaktuara në katër objektiva strategjike, ku secili prej tyre përcakton qëllimin e përgjithshëm, i detajuar në objektiva specifike me një përshkrim të rezultateve të pritshme, që do të arrihen gjatë periudhës së strategjisë bashkë me treguesit e përcaktuar në planin e veprimit, të cilët do të shërbejnë si tregues të qartë (cilësorë dhe sasiorë) në drejtim të vlerësimit të arritjes së secilit objektiv strategjik.

Objektivi Strategjik 1: Konsolidimi i veprimtarisë në mënyrë të pavarur, efëcente dhe profesionale.

- **Objektivi Specifik 1.1:** Plotësimi i vendeve vakante në njësinë e inspektorëve dhe zhvillimi profesional.

Ky objektiv specifik konsiston në plotësimin e vakancave dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në bashkëpunimin mes institucioneve shtetërore duke kërkuar komandimin e magistratëve, por edhe përmes ndjekjes së punës për rishikim të kuadrit ligjor që synon kriteret hyrëse në ILD dhe aspekte të rëndësishme të organizimit të brendshëm. Zhvillimi profesional, përmes monitorimit të trajnimeve, veçanërisht me aktorë të huaj, është rezultati i synuar drejt rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore të ILD-së.

- **Objektivi Specifik 1.2:** Forcimi i autonomisë financiare dhe krijimi i kushteve bashkëkohore për ushtrimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Si objektiv specifik, konsiston në hartimin e kërkesave të nevojshme buxhetore, për përmbushjen e veprimtarisë dhe modernizimin e infrastrukturës për punonjësit e ILD-së, si dhe

publikun. Qëllim tjetër është përshtatja e mjediseve të punës sipas kushteve bashkëkohore dhe ofrimin e lehtësirave në kryerjen e funksioneve dhe veçanërisht për të krijuar ambiente të përshtatshme për marrjen në pyetje të magjistratëve apo personave të tjerë në kuadër të procesit të verifikimit/hetimit disiplinor dhe njëkohësisht për të krijuar kushte për njësinë e pritjes së qytetarëve që paraqiten në ambientet e ILD-së.

- **Objektiv specifik 1.3:** Rishikimi i kuadrit rregullator për ushtrimin e veprimtarisë.

Në këtë objektiv specifik pritet të rishikohen dhe konsolidohen rregullat e brendshme të veprimtarisë me synim përshtatjen e tyre me dinamikën e zhvillimeve nga praktika e organeve kompetente që gjykojnë mbi procedurat e ndjekura nga ILD në procedimin disiplinor, por edhe në funksion të përmirësimit të nevojave që diktohen nga praktika dhe nga faktorë të jashtëm.

- **Objektivi Specifik 1.4:** Matja e performancës së institucionit përmes monitorimit dhe procesit të vlerësimit.

Përmes këtij objektivi synohen rezultate në drejtim të matjes së performancës së njërive përbërëse të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përmes sigurimit të informacionit të plotë statistikor dhe në kohë reale, lidhur me procesin e trajtimit të ankesave/çështjeve kryesisht të depozituara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe monitorimit të vazhdueshëm, në funksion të identifikimit të mangësive dhe gjetjen e zgjidhjeve për t'i adresuar mangësitë. Si pjesë përbërëse të këtij procesi janë edhe matja e treguesve sasiorë për vlerësimin e inspektorëve.

Objektivi Strategjik 2: Fuqizimi i veprimtarisë për matjen e performancës së subjekteve të hetimit disiplinor mbi cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë sipas standardeve evropiane.

- **Objektivi Specifik 2.1:** Krijimi i një sistemi të plotë dhe afatgjatë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë.

Nëpërmjet këtij objektivi specifik konsiston në marrjen e disa masave organizative dhe funksionale me qëllim vlerësimin/monitorimin e vazhdueshëm të standardeve të vendosura, në funksion të përmirësimit të proceseve të punës për shqyrtimin e ankesave, kryerjen e hetimeve disiplinore dhe kryerjen e inspektimeve.

- **Objektivi Specifik 2.2:** Forcimi i kapaciteteve profesionale për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të magjistratëve, subjekte të procedimit disiplinor.

Ky objektiv specifik konsiston në forcimin e mekanizmave institucionalë të bashkëpunimit nëpërmjet nënshkrimit të memorandumeve, ndërmarrjes së tryezave të përbashkëta për

diskutime profesionale me synim ngritjen e kapaciteteve për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të magistratëve.

- **Objektivi Specifik 2.3:** Trajtimi i ankesave të ardhura dhe ecuria e backlog-ut.

Nëpërmjet këtij objektivi specifik do të evidentohen marrja e masave për monitorim të vazhdueshëm të ecurisë së trajtimit të ankesave, në mënyrë që të shmangët krijimi i stokut të ankesave të ardhura drejtpërdrejt në ILD, si dhe përfundimin e trajtimit të ankesave të përcjella nga institucionet përpara periudhës tranzitore.

Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

- **Objektivi Specifik 3.1:** Ngritja e një sistemi efektiv dhe të unifikuar të teknologjisë së informacionit për menaxhimin elektronik të çështjeve.

Përmes këtij objektivi synohet të arrihet finalizimi i përgatitjes së Udhërrëfyesit për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë që përcakton hapat konkretë drejt zhvillimit të një sistemi të menaxhimit të çështjeve, me kontributin përkatës pranë Grupit Ndërinstitucional të Punës. Duke qenë se ky objektivi strategjik është i ndërlidhur me faktorë të jashtëm, aktivitetet e parashikuar për realizimin e tij konsistojnë në disa masa, të cilat janë të ndërvarura me Udhërrëfyesin e digjitalizimit të sistemit të drejtësisë. Objektivat specifikë do të jenë të rishikueshëm në varësi të miratimit të udhërrëfyesit. Aktualisht, rezultatet e pritshme janë kontraktimi i shërbimeve të ekspertizës për hartimin e termave të biznesit dhe dokumenteve me komponentët përbërës të sistemit, vënia në zbatim e sistemit dhe parashikimi për mirëmbajtjen, si dhe hartimi i rregullave për përdorimin e tij. Treguesit për matjen e këtyre aktiviteteve do të mundësohen përmes miratimeve, të cilat do t'i nënshtrohen konsultimeve me Bordin Drejtues të QTI-së.

Rezultati i pritshëm për këtë objektivi specifik lidhet me aktivitete, të cilat brenda periudhës së zbatimit të planit strategjik do të mundësojnë vënien në punë të sistemit elektronik.

Objektivi Strategjik 4: Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

- **Objektivi Specifik 4.1:** Rritja e transparencës nëpërmjet komunikimit dhe bashkëpunimit me publikun.

Nga ky objektivi specifik pritet përmirësim në vijim i komunikimit me publikun e gjerë në përputhje me programin e transparencës, përmes takimeve me ankuesit, vënies në dispozicion të informacioneve në faqen zyrtare, për aktivitetet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, publikimin e akteve rregullatore, njoftimeve, raporteve të ndryshme, statistikave, rubrikave me informacion të thjeshtuar për publikun të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

- **Objektivi Specifik 4.2:** Ndërgjegjësimi i publikut për rolin dhe funksionet e ILD-së.

Rezultati për këtë objektiv, do jetë zbatimi i aktiviteteve të programit për informimin dhe komunikimin publik në ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjëse për publikun, si dhe vënia në dispozicion i materialeve informuese.

- **Objektivi Specifik 4.3:** Parandalimi i cenimit të integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ndjekja e procedurave të sinjalizimit.

Ky objektiv specifik konsiston në miratimin e planit të integritetit, i cili i shërben institucionit në identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e tërësisë së rreziqeve, që cenojnë integritetin e institucionit dhe individëve që punojnë në të, si dhe është një dokument pune ku përcaktohen masa konkrete për trajtimin e risqeve të integritetit dhe arritjen e objektivave strategjikë dhe specifikë të institucionit. Nga ana tjetër, ndjekja dhe zbatimi i kuadrit ligjor për sinjalizimin, është masë e vendosur në këtë objektiv strategjik, e cila do të matet përmes numrit të rasteve të paraqitura dhe procedurave hetimore të zhvilluara.

METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR RAPORTIN E PLANIT STRATEGJIK

Metodologjia e Raportit të Monitorimit, përshkruan procesin e ndjekur gjatë hartimit të raportit dhe ka si qëllim kryesor të mundësojë udhëzimet e nevojshme për lehtësimin në kuptueshmërinë e tij, si dhe të orientohet drejt prezantimit të rezultateve kryesore për të nxjerrë në pah arritjet, sfidat dhe rekomandimet e adresuara për përmirësim pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për të siguruar një proces monitorimi bazuar në arritje konkrete, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë realizon komunikime intensive me njësitë e tjera përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit, me qëllim prezantimin e drejtë dhe të qartë të rezultateve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës së raportimit.

Kështu, gjatë periudhës të hartimit, është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm në varësi të specifikave për plotësimin e dokumentit raportues me njësitë përgjegjëse, me qëllim evidentimin e rasteve të suksesit, të cilat kanë sjellë rezultate të dukshme në veprimtarinë e tyre, gjithashtu identifikimin e sfidave, problematikave dhe komponentëve të cilët kanë ndikuar apo penguar progresin apo zbatimin e aktiviteteve të parashikuara.

Fazat e ndjekura për hartimin e Planit Strategjik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë .

Fazat që janë ndjekur për përgatitjen dhe konsolidimin e raportimit të monitorimit dhe performancës, paraqiten si më poshtë:

- Fillimisht është dërguar kërkesa për kontribut tek të gjitha njësitë përgjegjëse;
- Koordinimi dhe unifikimi i të dhënave të ardhura nga informacionet;
- Shqyrtimi i ecurisë së treguesve dhe alternativa për nën aktivitete;
- Organizimi i takimeve të vogla me njësitë përgjegjëse ku është përcaktuar vijim i punës për çdo aktivitet të planit;
- Hartimi i raportit të monitorimit;

Metodologjia e analizimit të të dhënave për Planin Strategjik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

- Raporti shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur grafikë, analiza të thelluara edhe vizualisht përmes tabelave. Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës për Objektivet Strategjike.
- Prezantimi i rezultateve mbi zbatimin e masave është prezantuar me sfond me ngjyrë sipas nivelit të zbatimit (*të zbatuara plotësisht/ të zbatuara pjesërisht/ të pazbatuara*).
- **Përcaktimi i nivelit të zbatimit të masave** (në përqindje) është ai i raportuar nga secila njësi përgjegjëse, dhe është evidentuar në kontributet e përcjella prej tyre mbi çdo masë të përcaktuar. Gjithashtu, shkalla e zbatimit të masave është përcaktuar në bazë të intervalit:
 - *E zbatuar*: masa e cila është përmbushur në vlerën 100%;
 - *Pjesërisht e zbatuar/Në proces*: masa e cila në periudhën e raportimit ka pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijon të jetë në zbatim dhe ka arritje të pjesshme.
 - *E pazbatuar*: masa e cila nuk ka pasur zhvillim dhe progres për periudhën raportuese (vlera e raportuar 0%).

KREU V - MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Në kuadër të zbatimit dhe monitorimit të Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit 2023-2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka miratuar urdhrin nr. 134/1, datë 29.12.2023 “Për mënyrën e zbatimit, monitorimit dhe raportimit të planit strategjik dhe planit të veprimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025”.

Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, parashikon treguesit kryesorë të performancës, me qëllim matjen e arritjeve, metodave të koordinimit, monitorimit dhe raportimit, si dhe buxhetin e përgjithshëm të zbatimit të tij.

Plani Strategjik dhe Plani i Veprimit 2023- 2025, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, konsiston në:

- 4 (katër) Objektiva Strategjik;
- 11 (njëmbëdhjetë) Objektiva Specifike/nënobjektiva;
- 44 (dyzet e katër) Aktivitete/Masa;

Plani Strategjik dhe qëllimet strategjike gjenden të përcaktuara në 4 (katër) objektiva të përgjithshëm, ku secili prej tyre përcakton qëllimin e përgjithshëm, i zbërthyer në 11 (njëmbëdhjetë) Objektiva Specifike të shpërndara përkatësisht në 43 (dyzet e tre) aktivitete/masa, me një përshkrim të rezultateve të pritshme, që do të arrihen gjatë periudhës së strategjisë bashkë me treguesit përkatës, të cilët do të shërbejnë si tregues të qartë (cilësorë dhe sasiorë) në drejtim të vlerësimit të arritjes së secilit objektiv strategjik.

Bazuar në urdhrin nr. 134/1, datë 29.12.2023 “Për mënyrën e zbatimit, monitorimit dhe raportimit të planit strategjik dhe planit të veprimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025”, janë përcaktuar aspekte të karakterit rregullues të procesit të monitorimit, detyrimi për raportim sipas çështjeve që mbulojnë njësitë që kanë në objekt të veprimtarisë masa apo aktivitete konkrete, afatet dhe struktura përgjegjëse për monitorimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit 2023-2025.

Struktura përgjegjëse për monitorimin dhe koordinimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit 2023-2025 të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë , është Sektori i Raportimeve dhe Përfaqësimit.


Gjithashtu Sekretari i Përgjithshëm ndjek dhe monitoron zbatimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit, duke zhvilluar takime për të diskutuar mbi ecurinë e masave të parashikuara në plan me titullarët e njësive përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e aktiviteteve të përcaktuara. Takimet në kuadër të Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit, zhvillohen jo më pak se një herë në 6 (gjashtë) muaj dhe në çdo rast që çmohet e nevojshme, me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm.

Në përmbushje të detyrave funksionale Sekretari i Përgjithshëm, do të asistohet nga specialisti i Sektorit të Raportimeve dhe Përfaqësimit.


Në përfundim të çdo periudhe monitorimi, raporti i monitorimit i përcillet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë mbi përmbushjen e objektivave/masave për periudhat përkatëse të paracaktuara, mbi zbatimin e masave të “Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për periudhën 2023-2025”, bashkë me përllogaritjen në përqindje (%), si një kriter matës mbi përmbushjen e aktiviteteve sipas çdo objekti specifik.

Në kuadër të kontributeve të ardhura për përmbushjen e masave/aktiviteteve të përcaktuara, rezulton se objektivat strategjik për periudhën Janar –Qershor 2025, të jenë realizuar në vlerat e mëposhtme:


Objektivi Strategjik 1




Objektivi Strategjik 2



Objektivi Strategjik 3



Objektivi Strategjik 4



KREU VI - ANALIZA E ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT GJATË PERIUDHËS JANAR – QERSHOR TË VITIT 2025

Gjatë periudhës së raportimit Janar – Qershor 2025 është përcjellë informacioni i përgjithshëm mbi realizimin e çdo mase/aktivitet, Objektiv Specifik dhe Objektiv Strategjik.

Përkatësisht realizimi i objektivave strategjikë dhe masave të tyre përkatëse, gjatë periudhës Janar – Qershor 2025 rezulton si më poshtë:

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1. KONSOLIDIMI I VEPRIMTARISË SË ILD-SË NË MËNYRË TË PAVARUR, EFICENTE DHE PROFESIONALE ËSHTË REALIZUAR NË NIVELIN 72.6%

Për periudhën e raportimit, janë realizuar 9 aktivitete plotësisht, 3 aktivitete janë realizuar pjesërisht, 3 aktivitete janë realizuar në (gjashtë) mujorin e parë, 3 aktivitete janë realizuar në vitin 2023 dhe në vitin 2024 janë realizuar 2 nga totali prej 20 aktiviteteve.

Objektiv Specifik 1.1. Plotësimi i vendeve vakante në njësinë e inspektorëve dhe zhvillimi profesional është realizuar nga monitorimi i 6 masave të vendosura për realizimin e tij. Konkretisht:

1.1.1	Paraqitja e kërkesave për komandim për plotësimin e vendeve vakante me inspektorë magjistratë, drejtuar KLGJ dhe KLP.
1.1.2	Shpallja e njoftimit të fillimit të procedurës përzgjedhëse të kandidatëve për pozicionin e inspektorit jomagjistrat
1.1.3	Rritja e kapaciteteve dhe zhvillimi profesional i njësisë së inspektorëve.
1.1.4	Rritja e kapaciteteve të punonjësve në shërbim civil sipas pozicioneve respektive të punës.
1.1.5	Përtëritja e kërkesës në Kuvendin e Shqipërisë për miratim të ndryshimeve ligjore për kriteret hyrëse në njësinë e inspektorëve.
1.1.6	Propozime për ndryshime ligjore në lidhje me ndryshimin e organit miratues, të strukturës organizative të Zyrës së ILD-së

Për periudhën Janar – Qershor 2025, nga 6 aktivitetet e parashikuara për Objektivin Strategjik 1, Objektivi Specifik 1.1, rezulton se janë zbatuar plotësisht 3 aktivitete në masën 100% dhe 1 masë është *zbatuar pjesërisht*, ndërsa për 2 aktivitete nuk ka ndryshime nga periudha e mëparshme e raportimit, konkretisht:

Paraqitja e kërkesave për komandim për plotësimin e vendeve vakante me inspektorë magjistratë, drejtuar KLGJ dhe KLP. Në funksion të realizimit të këtij aktiviteti/mase Për

periudhën e raportimit, me shkresën nr. 3212/2, datë 20.01.2025, nuk është pranuar kandidatura e propozuar. Pritet që KLGJ të njoftojë mbylljen e procedurës për kërkesën e ILD-së. Në përfundim të procedurës së shpalljes nga KLGJ, do të përcillet kërkesa e re për komandim. Nga ana tjetër me kërkesën nr. 337 prot., datë 06.02.2025, është paraqitur kërkesa në KLGJ për nisjen e procedurave, për komandimin e 1 magjistrati gjyqtar për pozicionin "Këshilltar". Procedura është shpallur më datë 27.02.2025 dhe në përfundim të saj nuk ka patur kandidatura dhe me kërkesën nr. 337/1 prot., datë 26.03.2025 është paraqitur kërkesa për rishpalljen e procedurës për komandimin e një magjistrati në pozicionin "Këshilltar". Procedura është në proces, pasi nuk ka komunikim zyrtar apo njoftim në faqen zyrtare të KLGJ-së. Lidhur me kërkesën e vitit 2024 për komandim në KLP, procedura e komandimit është shpallur dhe procedura vijon të jetë në proces, pasi nuk ka komunikim zyrtar apo njoftim në faqen zyrtare të KLP-së.

- Shpallja e njoftimit të fillimit të procedurës përzgjedhëse të kandidatëve për pozicionin e inspektorit jomagjistrat. Në funksion të realizimit të këtij aktiviteti/mase janë kryer:

Për periudhën e raportimit, kanë aplikuar 19 kandidatë, për 7 kandidatë në përfundim të verifikimit janë nxjerrë vendimet e ndalimit, për 2 kandidatë janë nxjerrë vendimet e tërheqjes, pasi kandidatë kanë njoftuar tërheqjen nga kandidimi dhe për 10 kandidatë procedurat e verifikimit janë në proces.

- Rritja e kapaciteteve dhe zhvillimi profesional i njësisë së inspektorëve. Gjatë periudhës së raportimit Janar –Qershor 2025 janë zhvilluar trajnimet si vijon:
 1. Zbatimi i ndalimit me ligj të krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes me fokus LGBTIQ+.
 2. Efikasiteti i ndjekjes penale në rastet e dhunës me bazë gjinore.
 3. Efektiviteti i zbatimit të urdhrave të mbrojtjes dhe procedimet në rast të shkeljes së tyre.
 4. Inspirimi dhe motivimi i individëve të shohin potencialin e tyre.
 5. Ndertimi i ekuilibrit midis publike dhe private.
 6. Ndërtimi i besimit dhe integritetit për të mirën e përbashkët.
 7. Ndikimi pozitiv për të promovuar vlerat e drejtësisë dhe barazisë.
 8. Lirimi me kusht.
 9. E drejta dhe jurisprudenca ndërkombëtare për lirin me kusht.
 10. Aspekte procedurale të shqyrtimit të kërkesës për lirin me kusht.
 11. Interpretimi i nenit 64 të Kodit Penal lidhur me masën e dënimit që duhet të ketë vuajtur i dënuari midis dënimit që parashikon dispozita dhe dënimit të caktuar në vendim.
 12. Vlera e raportit të vlerësimit nga shërbimi i provës.
 13. Lirimi me kusht i të miturve.
 14. Juridiksioni gjyqësor rishikues mbi lirin me kusht.
 15. Lirimi me kusht i të dënuarve me burgim të përjetshëm.
 16. Standardet e GJEDNJ-së dhe aspekti krahasimor me vendet e tjera....etj.
 17. Mjetet e komunikimit, tradicionale dhe dixhitale, përparësitë dhe kufizimet.
 18. Njoftimi për shtyp,
 19. Konferenca për shtyp.

20. Intervista. Format moderne të komunikimit të drejtpërdrejtë me opinionin publik, nëpërmjet faqes së internetit, mediave sociale, mesazhe të filmuara, etj.
21. Liria për tu shprehur online nëpërmjet portaleve të lajmeve në internet; qasja në informacionet, opinionet dhe shprehjet e të tjerëve, nga njëra anë, dhe respektimi i reputacionit ose të drejtave të të tjerëve, përfshirë edhe të drejtën e tyre për privatësi, nga ana tjetër.
22. Censura, shpifja dhe fyerja.
23. Format e ndikimit të medias te sistemi i drejtësisë.
24. Komunikimi në kohë krize.
25. Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm.
26. Karakteristikat në gjykimin civil dhe penal. Gjykimi I pandërprerë, etj.
27. Kufijtë e rigjyqimit pas pranimit të kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor.
28. International child abduction.
29. Arsyetimi i vendimit lidhur me masat e sigurimit.
30. Elementët e detyrueshëm të vendimit të masës së sigurimit.
31. Parashikimi ligjor i pavlefshmërisë për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimit.
32. Pasojat e deklarimit të pavlefshmërisë.
33. Praktika gjyqësore lidhur me trajtimin e rasteve të pavlefshmërisë për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimit.
34. Konflikti i interesit të magjistratëve në kuadër të legjislacionit vendas dhe praktikave të GJEDNJ.
35. Përgjegjësia disiplinore e magjistratëve. Garancitë procedurale dhe themelore në kuadër të legjislacionit vendas dhe të GJEDNJ.

EU4Justice

- • Sesi 1- Thellimi i njohurive mbi Inspektimet Tematike dhe Institucionale.
- • Sesi 2- Diskutimi i sfidave që lidhen me Inspektimet Institucionale dhe Tematike.

CEPEJ

- Rritja e aftësive inspektuese sipas udhëzuesve të CEPEJ.
- Përtëritja e kërkesës në Kuvendin e Shqipërisë për miratim të ndryshimeve ligjore për kritereve hyrëse në njësinë e inspektorëve. Në lidhje me këtë aktivitet/masë nuk ka patur zhvillime të reja për këtë periudhë raportimi.
- Propozime për ndryshime ligjore në lidhje me ndryshimin e organit miratues, të strukturës organizative të Zyrës së ILD-së. Në funksion të këtij aktiviteti/masë zbatimi i tij është mbyllur në 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit 2024.

Objektivi Specifik 1.2. Forcimi i autonomisë financiare dhe krijimi i kushteve bashkëkohore për ushtrimin e veprimtarisë është realizuar në masën 100% për dy aktivitete të përmbushura gjatë vitit 2024, konkretisht 1.2.2 dhe 1.2.3, ndërsa masa 1.2.3 është realizuar pjesërisht në masën 33%.

1.2.1	Hartimi i kërkesave buxhetore, sipas nevojave institucionale
1.2.2	Rikonstruksioni i ambienteve të brendshme për pajisjen me ambiente pune për të gjithë numrin e punonjësve, sipas strukturës dhe organikës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.
1.2.3	Krijimi i një ambienti të posaçëm për pritjen e publikut dhe për marrjen në pyetje të ankuesve/magjistratëve/dëshmitarëve/personave të tjerë të përfshirë në proces, në kuadër të procesit verifikimit/hetimit disiplinor.

Për periudhën Janar- Qershor 2025, në Objektivi Strategjik 1, Objektivi Specifik 1. 2, rezultojnë 3 masa, 2 prej të cilave janë realizuar plotësisht dhe janë raportuar gjatë viti 2024. 1 masë rezulton e *zbatuara pjesërisht në masën 33%* konkretisht:

- Hartimi i kërkesave buxhetore, sipas nevojave institucionale. Në funksion të kësaj mase është kryer procesi i hartimit të kërkesave buxhetore të PBA, e cila shtrihet përgjatë vitit në 3 faza: Faza I -faza përgatitore (e cila përfundon me dërgimin e kërkesave buxhetore në MF në datë.1 maj) Faza II - faza teknike (e cila përfundon me dërgimin e formateve dhe anekseve të PBA në datë. 1 shtator) Faza III - e cila i përket detajimit të buxhetit të vitit pasardhës me miratimin në Kuvend të ligjit të buxhetit
- Rikonstruksioni i ambienteve të brendshme për pajisjen me ambiente pune për të gjithë numrin e punonjësve, sipas strukturës dhe organikës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Në lidhje me këtë aktivitet/masë, për periudhën e raportimit Janar Qershor 2025 nuk ka raportim pasi ky aktivitet ka përfunduar në vitin 2024.
- Krijimi i një ambienti të posaçëm për pritjen e publikut dhe për marrjen në pyetje të ankuesve/magjistratëve/dëshmitarëve/personave të tjerë të përfshirë në proces, në kuadër të procesit verifikimit/hetimit disiplinor. Sa i takon këtij aktiviteti raportohet se për periudhën e raportimit Janar Qershor 2025 nuk ka raportim pasi ky aktivitet ka përfunduar në vitin 2024.

Objektivi Specifik 1.3. Rishikimi i kuadrit rregullator për ushtrimin e veprimtarisë është realizuar plotësisht nga monitorimi i 5 masave të vendosura për realizimin e tij, konkretisht:

1.3.1	Hartimi dhe miratimi rregullores së brendshme pas miratimit të strukturës së re organizative.
1.3.2	Hartimi dhe miratimi i rregullores për zgjedhjen dhe emërimin e Zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë.
1.3.3	Hartimi i planit vjetor të inspektimit.
1.3.4	Vlerësimi i kërkesave për ndryshim të akteve rregullatore në fuqi.
1.3.5	Rishikimi i rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të inspektorëve.

Për periudhën Janar Qershor 2025, në kuadër të Objektivit Strategjik 1, Objektiv Specifik 1.3, janë parashikuar 5 masa rezulton se 3 aktivitete/masa janë përfunduar dhe janë raportuar të realizuara gjatë vitit 2023 (1.3.1 dhe 1.3.2) dhe vitit 2024 (1.3.5), ndërsa 2 aktivitete/masa vijon si më poshtë:

- Në funksion të aktivitetit nr. 1.3.3 janë hartuar kërkesat drejtuar subjekteve propozuese KLGJ, KLP, PP dhe MD, të cilat janë shqyrtuar në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve, dhe miratuar me vendimin nr. 5, datë 31.01.2025 “Për miratimin e planit të inspektimeve për vitin 2025”. Si dhe janë hartuar vendimet e inspektimeve sipas Planit të Inspektimeve të miratuar dhe ka filluar puna për zbatimin e tij.
- Në lidhje me aktivitetin 1.3.4 i cili ka të bëjë me vlerësimin e kërkesave për ndryshim të akteve rregullatore në fuqi, Janë miratuar 15 akte nga të cilat:
 - 1 vendim për miratimin e planit të inspektimit për vitin 2025;
 - 8 vendime inspektimi;
 - 1 urdhër për dorëzim të praktikave të inspektorëve;
 - 1 urdhër ndryshues
 - 4 akte të vlerësuar nga QTI;

Objektiv Specifik 1.4. Matja e performancës së institucionit përmes monitorimit dhe procesit të vlerësimit është realizuar nga monitorimi i 6 masave të vendosura për realizimin e tij, konkretisht:

1.4.1	Riorganizimi i strukturës organizative për matjen e performancës.
1.4.2	Përgatitja e kuadrit rregullator për analizim dhe monitorim.
1.4.3	Grumbullimi, përpunimi dhe analizimi i informacionit statistikor.
1.4.4	Ndjekje të ecurisë së ankimeve ndaj vendimeve të arkivimit dhe mbylljes së hetimeve të ILD-së në Këshilla.
1.4.5	Evidencimi i numrit të kërkesave për procedim drejtuar këshillave dhe ecuria gjyqësore, nëse ka.
1.4.6	Përgatitja e të dhënave statistikore për vlerësimin e inspektorëve.

Për periudhën Janar – Qershor 2025 në Objektivin Specifik 1.4, nga 6 masa gjithsej, për 2 masa (1.4.1 dhe 1.4.2) realizimi i tyre është përmbyllur gjatë vitit 2023. Për periudhën e raportimit, për 4 masat, 1.4.3., 1.4.4, 1.4.5, 1.4.6, ecuria e zbatimit rezulton të jetë *të zbatuara plotësisht* dhe konkretisht:

- Grumbullimi, përpunimi dhe analizimi i informacionit statistikor. Në funksion të këtij aktiviteti ka vijuar puna me grumbullimin përpunimin dhe analizimin e informacionit statistikor, nëpërmjet të cilave janë kryer raportime periodike javore lidhur me ankesat

dhe trajtimin e tyre ne ILD, dhe është përgatitur pjesa përkatëse për raportin vjetor të veprimtarisë së Zyrës së ILD. Ndërsa nuk është hartuar ende vjetari statistikor.

- Ndjekje të ecurisë së ankimeve ndaj vendimeve të arkivimit dhe mbylljes së hetimeve të ILD-së në Këshilla. Për realizimin e këtij aktiviteti është ndjekur ecuria e ankimeve ndaj vendimeve të arkivimit dhe mbylljes së hetimeve të ILD-së në Këshilla¹. Rezulton se ndaj vendimeve të ILD-së janë kryer 64 ankime.
- Evidencimi i numrit të kërkesave për procedim drejtuar këshillave dhe ecuria gjyqësore, nëse ka. Në lidhje me këtë masë është raportuar se 1 kërkesa për procedim është pranuar pa ndryshime mase; 1 kërkesë është rrëzuar nga Këshilli; 2 kërkesa janë pezulluar; dhe 1 kërkesë është mbyllur pa vendim. Gjithashtu nuk ka raste të paraqitura në gjykatë.
- Përgatitja e të dhënave statistikore për vlerësimin e inspektorëve. Në funksion të kësaj mase për periudhën e raportimit janë në proces vlerësimi 4 inspektorë.

¹ Komisioni i Përkohshëm i Shqyrtimit të Ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit disiplinor.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2. FUQIZIMI I VEPRIMTARISË PËR MATJEN E PERFORMANCËS SË SUBJEKTEVE TË HETIMIT DISIPLINOR MBI CILËSINË DHE EFIKASITETIN E DHËNIES SË DREJTËSISË SIPAS STANDARDEVE EVROPIANE ËSHTË REALIZUAR PLOTËSISHT NË MASËN 100%

Për periudhën e raportimit, për Objektivin Strategjik nr. 2, janë parashikuar 10 aktivitete. Për një aktivitet (2.2.1) ecuria e zbatimit të tij ka përfunduar në 2023 dhe është raportuar e përfunduar në raportin e monitorimit për vitin 2023.

Objektivi Specifik 2.1: Krijimi i një sistemi të plotë dhe afatgjatë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë është realizuar nga monitorimi i 5 masave të vendosura për realizimin e tij, konkretisht:

2.1.1	Vlerësimi i tematikave për përfshirje në planin vjetor të inspektimeve (kërkesat e motivuara të KLGJ, KLP, PP dhe MD; dispozita ligjore dhe analiza të brendshme të punës).
2.1.2	Ndjekja e zbatimit të planit vjetor të miratuar, sipas afateve të realizimit.
2.1.3	Ndjekja dhe zbatimi i rekomandimeve sipas inspektimeve të kryera.
2.1.4	Analizim të objektit të ankesave të ardhura dhe mënyra e përfundimit të tyre pas shqyrtimit.
2.1.5	Përpunimi dhe analizimi i informacioneve periodike të gjykatave dhe zyrave të prokurorive/KLGJ/KLP/PP.

Për periudhën Janar – Qershor 2025, në Objektivi Strategjik 2, Objektivi Specifik 2.1, nga 5 aktivitete/masa rezulton të jenë realizuar plotësisht, konkretisht:

- Vlerësimi i tematikave për përfshirje në planin vjetor të inspektimeve (kërkesat e motivuara të KLGJ, KLP, PP dhe MD; dispozita ligjore dhe analiza të brendshme të punës). Në funksion të kësaj mase për këtë periudhë raportimi të gjitha aktivitetet janë kryer dhe ILD i është vënë në dispozicion një dokument informativ mbi tematikat e inspektimeve që do të përfshihen në planin vjetor të inspektimeve. Aktiviteti është realizuar plotësisht.
- Ndjekja e zbatimit të planit vjetor të miratuar, sipas afateve të realizimit. Për këtë periudhë raportimi, për vitin 2025, janë planifikuar 8 inspektime tematike. 1 inspektim është përfunduar brenda afatit të përcaktuar në planin e inspektimit "Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rrethe mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim për periudhën 01.05.2024 -31.07.2024" në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Elbasan Vlorë.
- Për periudhën e raportimit janë në fazë ndjekje dhe zbatimi të rekomandimeve 2 inspektime (shpallja dhe arsyetimi (2023) dhe ndërmjetësimi). Në total janë lënë 16 rekomandime, afati I të cilave përfundon në 6-mujorin II të vitit 2025 dhe monitorimi i tyre do të jetë pjesë e raportit për 6 të dytë. Analizim të objektit të ankesave të ardhura

dhe mënyra e përfundimit të tyre pas shqyrtimit. Në funksion të kësaj mase rezulton se është raportuar informacioni periodik javor, lidhur me numrin e ankesave të ardhura dhe të trajtuara.

- Përpunimi dhe analizimi i informacioneve periodike të gjykatave dhe zyrave të prokurorive/KLGJ /KLP /PP. Në funksion të kësaj mase rezulton se është kryer realizimi i analizës përkatëse lidhur me informacionin statistikor me baza 6 mujore të dërguar nga gjykatat dhe Zyrat e prokurorive. Gjithashtu është kryer dhe hartimi i raportit për çdo 6-mujor, mbi veprimtarinë e gjykatave dhe prokurorive, është dërguar shkresa gjykatave përkatëse dhe Prokurorit të Përgjithshëm, ndërkohë po vijon puna me mbledhjen e informacioneve dhe hartimin e raportit mbi informacionin periodik.

Objektivi specifik 2.2: Forcimi i kapaciteteve profesionale për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të magistratëve, subjekte të procedimit disiplinor është realizuar gjatë vitit 2024, andaj ky objektivi është realizuar.

2.2.1	Forcimi i mekanizmave institucionalë të bashkëpunimit për verifikimin e pasurisë dhe integritetin e magistratëve.
2.2.2	Ndjekja dhe zbatimi i parashikimeve të memorandumit.
2.2.3	Ngritja e kapaciteteve

Për periudhën Janar- Qershor 2025, në Objektivi Strategjik 2, Objektivi Specifik 2.2, ka 3 aktivitete/masa, rezulton 1 aktivitet i përfunduar në 2023 dhe 2 aktivitete gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2024. Ky aktivitet rezulton i realizuar plotësisht.

Objektivi Specifik 2.3 Trajtimi i ankesave të ardhura dhe ecuria e backlog-ut është realizuar plotësisht pasi nga monitorimi i 2 masave të vendosura për realizimin e tij, konkretisht:

2.3.1	Ndjekja e trajtimit në vijimësi dhe me prioritet të ankesave të ardhura në ILD.
2.3.2	Ndjekja e trajtimit me prioritet i ankesave të mbartura nga institucionet e mëparshme sipas metodologjisë miratuara.

Për periudhën Janar – Qershor 2025, në Objektivi Strategjik 2, Objektivi Specifik 2.3, të 2 aktivitete/masa, rezultojnë të jenë *zbatuar plotësisht* konkretisht:

- Ndjekja e trajtimit në vijimësi dhe me prioritet të ankesave të ardhura në ILD. Për periudhën e raportimit, numri i ankesave të trajtuara me vendim arkivimi është 818, numri i ankesave të trajtuara me vendim për fillimin hetimi është 22 (6 vendime për fillim hetimi, ku njëri ka filluar me iniciativë) dhe numri i kërkesave për procedim është 5 (për 3 ankesa të shqyrtuara dhe 2 vendime me iniciativë).

- Ndjekja e trajtimit me prioritet i ankesave të mbartura nga institucionet e mëparshme sipas metodologjisë së miratuar. Ky aktivitet është realizuar plotësisht pasi afati për zbatimin e tij ishte viti 2023.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3. ZHVILLIMI I SISTEMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË ËSHTË REALIZUAR PJESËRISHT NË MASËN 67%

Për periudhën e raportimit, është parashikuar të realizohen 3 aktivitete, nga totali prej 5 aktiviteteve. Një aktivitet është realizuar plotësisht, 2 aktivitete janë të pa zbatueshme dhe 2 aktivitete janë realizuar pjesërisht.

Objektivi Specifik 3.1: Ngritja e një sistemi efektiv dhe të unifikuar të teknologjisë së informacionit për menaxhimin elektronik të çështjeve është realizuar pjesërisht nga monitorimi i 5 aktiviteteve të vendosur për realizimin e tij. Konkretisht:

3.1.1	Hartimi i udhërrëfyesit të sistemit të menaxhimit të çështjeve në ILD.
3.1.2	Hartimi i dokumentit të termave të biznesit për sistemin e menaxhimit të çështjeve në ILD.
3.1.3	Hartimi i dokumentit me specifikimet teknike për zhvillimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në ILD.
3.1.4	Zhvillimi i sistemit dhe mirëmbajtja e tij.
3.1.5	Hartimi i rregullores së roleve dhe përdorimit të sistemit.

Sa i takon 4 aktiviteteve (3.1.3, 3.1.4, 3.1.5), me afat realizimi në vitin 2024 dhe 2025, raportohet se këto aktivitete janë të ndërvarura nga miratimi i udhërrëfyesit për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë dhe zbatimi i tyre do të fillojë me miratimin e udhërrëfyesit. Nga ana e përfaqësuesve të ILD-së, janë përcjellë të dhënat e nevojshme pranë Kryetarit të GNP pranë KLGJ-së, për rrjedhojë ky aktivitet është i konsideruar i plotësuar. Për këtë periudhë raportimit nuk ka të dhëna për miratimin e tij.

Sa i takon aktivitetit 3.1.2, nga për këtë periudhë raportimi, është kërkuar në PBA 2025-2027 fond për hartimin e projektit për sistemin e menaxhimit të çështjeve në ILD, ky fond është miratuar me ligjin nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025". Do të vijohet me procedurat për realizimin e procedurës së hartimit të termave të referencës dhe specifikimeve teknike.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4. RITJA E TRANSPARENCËS DHE AKSESIT TË PUBLIKUT NË VEPRIMTARINË E ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË 87.5%

Objektivi Specifik 4.1. Rritja e transparencës nëpërmjet komunikimit dhe bashkëpunimit me publikun është realizuar nga monitorimi i 4 aktiviteteve të vendosura për realizimin e tij. Konkretisht:

4.1.1	Takime me ankuesit dhe asistencë në plotësimin e formularit të ankesës apo çështje të tjera.
4.1.2	Publikimi i urdhrave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, njoftimet dhe raporte të ndryshme, në faqen zyrtare të ILD.
4.1.3	Publikimi i buletineve dhe vjetarit statistikor.
4.1.4	Publikimi i informacionit për funksionimin e ILD-së në kuadër të programit të transparencës.

Për periudhën Janar – Qershor 2025, për Objektivin Strategjik 4, Objektivi Specifik 4.1, të 4 aktiviteteve, rezultojnë të jenë *zbatuar pjesërisht* në masën **87.5%**, konkretisht:

- Takime me ankuesit dhe asistencë në plotësimin e formularit të ankesës apo çështje të tjera. Për këtë periudhë raportimi janë në funksion të transparencës për veprimtarinë e institucionit por edhe aksesin e publikut edhe gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2025 janë përdorur mënyrat klasike të komunikimit, duke përmirësuar elementë për rritjen e efikasitetit të punës. Vëmendja maksimale ka qenë tek: Faqja zyrtare www.ild.al e përditësuar në informacion, në shqip dhe anglisht. Në faqen zyrtare, çdo të hënë vijon të publikohet ecuria e javore e punës në ILD sa i takon numrit të ankesave të administruara, atyre të trajtuara, atyre në proces trajtimi fillestar, verifikimi, arkivimi, hetimet dhe procedimet disiplinore. Posta elektronike info@ild.al, si mënyrë e shpejtë komunikimi për dërgimin e ankesave/dokumenteve, apo për të kërkuar informacion. Ka qenë në funksion të plotë numri zyrtar i telefonit, për një komunikim në kohë reale me publikun, institucione e qytetarë të interesuar, si një nga mënyrat për të garantuar të drejtën për informim. Pritja e qytetarëve çdo ditë pune, nga e hëna në të premte (nga ora 09.00-14.00) duke i asistuar sipas nevojës në plotësimin e formularit TIP të ankesës përmes punonjësve të Sektorit të Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, si strukturë përbërëse e Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse. Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në harkun kohor të 6 muajve të parë të vitit 2025 ka kryer: 194 takime me qytetarët, asistencë përmes telefonit me 102 qytetarë, anketa online në faqe me 12 qytetarë si dhe 11 takime me gazetarë, OJF e të tjera..
- Publikimi i urdhrave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, njoftimet dhe raporte të ndryshme, në faqen zyrtare të ILD.
Në faqen zyrtare, për periudhën Janar - Qershor 2025, është kryer publikimi i akteve, raporteve, njoftimeve, etj, sipas kërkesave të njësive përgjegjëse, si më poshtë:
1. Akte të Inspektorit - 9 akte;

2. Njoftime për media - 12 njoftime;
3. Njoftim publik për shpallje vendimi - 34 njoftime;
4. Vende vakante - 37 njoftime;
5. Buletin - 6 buletine (Dhjetor 2024 - Maj 2025)
6. Raporte dhe strategji - 1 material;
7. Raporte inspektimesh tematike - 4 raporte;
8. Rekrutim Inspektor jomagjistrat - 6 materiale;
9. Programi i transparencës - 10 materiale;

Gjithsej janë publikuar 119 materiale.

Krahas publikimit të materiale, është kryer edhe përditësimi i shifrave të punës javore në institucion, lidhur me ankesat e konfirmuara, ankesat e trajtuara, ankesat në proces trajtimi, ankesa në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar, vendime për fillim hetimi disiplinor dhe kërkesa për procedim disiplinor. Në funksion të këtij aktiviteti është kryer publikimi i të gjithave akteve dhe materialeve, sipas njoftimeve të kryera.

- Publikimi i buletineve dhe vjetarit statistikor. Në funksion të këtij aktiviteti është kryer publikimi i të gjithave buletineve.

1. Kryer publikimi i 6 buletineve (Dhjetor 2024 - Maj 2025)

2. Vjetari statistikor nuk është përcjellë asnjëherë për publikim.

- Publikimi i informacionit për funksionimin e ILD-së në kuadër të programit të transparencës. Në funksion të këtij aktiviteti Në faqen zyrtare, për periudhën Janar - Qershor 2025, është kryer publikimi i akteve, raporteve, njoftimeve, etj, sipas kërkesave të njësive përgjegjëse, si më poshtë:

Akte të Inspektorit - 9 akte;

Njoftime për media - 12 njoftime;

Njoftim publik për shpallje vendimi - 34 njoftime;

Vende vakante - 37 njoftime;

Buletin - 6 buletine (Dhjetor 2024 - Maj 2025)

Raporte dhe strategji - 1 material;

Raporte inspektimesh tematike - 4 raporte;

Rekrutim Inspektor jomagjistrat - 6 materiale;

Programi i transparencës - 10 materiale;

Gjithsej janë publikuar 119 materiale.

- Krahas publikimit të materialeve, është kryer edhe përditësimi i shifrave të punës javore në institucion, lidhur me ankesat e konfirmuara, ankesat e trajtuara, ankesat në proces trajtimi, ankesa në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar, vendime për fillim hetimi disiplinor dhe kërkesa për procedim disiplinor. Janë publikuar në faqen e web dhe rrjeteve sociale të gjitha takimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, brenda dhe jashtë vendit, me homologë, apo kategori të ndryshme interesi. Gjithashtu janë shpërndarë në të gjitha mediat njoftimet për shtyp, duke bërë të mundur publikimin e tyre

- *Objektiv Specifik: 4.2.* Ndërgjegjësimi i publikut për rolin dhe funksionet e ILD-së është realizuar në nivelin **100 %**, nga monitorimi i 2 masave të vendosura për realizimin e tij, konkretisht:

4.2.1	Konceptimi dhe realizimi i këndit informativ;
4.2.2	Zhvillimi i aktiviteteve informuese/edukuese në kuadër të programit për informimin dhe komunikimin publik të Zyrës së ILD-së.

Për periudhën Janar – Qershor 2025, në Objektivi Strategjik 4, Objektivi Specifik 4.2, të 2 aktivitete, rezulton të jenë *zbatuar plotësisht*, , konkretisht:

- Konceptimi dhe realizimi i këndit informativ. Në lidhje me këtë aktivitet/masë në funksion të transparencës për veprimtarinë e institucionit por edhe aksesin e publikut edhe gjatë 6 muorit të parë të vitit 2025 janë përdorur mënyrat klasike të komunikimit, duke përmirësuar elementë për rritjen e efikasitetit të punës. Vëmendja maksimale ka qenë tek: Faqja zyrtare www.ild.al e përditësuar në informacion, në shqip dhe anglisht. Në faqen zyrtare, çdo të hënë vijon të publikohet ecuria e javore e punës në ILD sa i takon numrit të ankesave të administruara, atyre të trajtuara, atyre në proces trajtimi fillestar, verifikimi, arkivimi, hetimet dhe procedimet disiplinore. Posta elektronike info@ild.al, si mënyrë e shpejtë komunikimi për dërgimin e ankesave/dokumenteve, apo për të kërkuar informacion. Ka qenë në funksion të plotë numri zyrtar i telefonit, për një komunikim në kohë reale me publikun, institucione e qytetarë të interesuar, si një nga mënyrat për të garantuar të drejtën për informim. Pritja e qytetarëve çdo ditë pune, nga e hëna në të premte (nga ora 09.00-14.00) duke i asistuar sipas nevojës në plotësimin e formularit TIP të ankesës përmes punonjësve të Sektorit të Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun, si strukturë përbërëse e Drejtorisë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse
- Zhvillimi i aktiviteteve informuese/edukuese në kuadër të programit për informimin dhe komunikimin publik të Zyrës së ILD-së. Në funksion të këtij aktiviteti janë realizuar takimet si vijon:
 - Pjesëmarrës të Akademisë së Integritit Evropian dhe Negociatave (AIEN) zhvilluan një vizitë studimore në ambientet e ILD-së, gjatë së cilës zhvilluan një bashkëbisedim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani, në kuadër të modulit “Shteti i së drejtës”.
 - Të angazhuar në administratën publike, institucione jo publike, organizata jo qeveritare, nga radhët e juristëve e medias, pjesëmarrësit e kësaj akademie u njohën nga z. Metani me rolin dhe funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe sfidat e institucionit, si pjesë e rëndësishme e strukturës së re të krijuar nga reforma në drejtësi e më tej, të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
 - Në vijim të një tradite të krijuar tashmë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një takim në ambientet e institucionit me klasën e vitit 2024-2025 të programit LEAD Albania, të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim.
 - Në nisje të bashkëbisedimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i njohu pjesëmarrësit me rolin dhe funksionet e ILD-së, si institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor

ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

- Më tej z. Metani iu përgjigj interesimit të tyre mbi aspekte të punës së institucionit, që nga marrja e ankesave të qytetarëve a institucioneve, shqyrtimi e verifikimi i tyre, hetimi disiplinor e procedimi, si dhe inspektimet tematike e institucionale.
- Pjesëmarrësit e programit një vjeçar LEAD Albania, janë profesionistë të rinj, të shkolluar brenda e jashtë vendit, të cilët përmes kësaj eksperience, kanë mundësinë e përvojës së drejtpërdrejtë në procesin e qeverisjes, përmes angazhimit për një vit, si pjesë e kabineteve të institucioneve më të larta shtetërore në vend, në rastin e klasës 2025, pranë kryeministrit, ministrive të ndryshme, e deri tek institucione të drejtësisë, si Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Objektiv Specifik: 4.3. Parandalimi i cenimit të integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ndjekja e procedurave të sinjalizimit është realizuar plotësisht nga monitorimi i 3 masave të vendosura për realizimin e tij, konkretisht:

4.3.1	Hartimi i planit të integritetit për ILD;
4.3.2	Ndjekja dhe zbatimi i ecurisë së planit të integritetit
4.3.3	Zhvillimi i procedurave në kuadër të sinjalizimit e veprimeve ose praktikave korruptive të punonjësve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Për periudhën Janar – Qershor 2025, për Objektivin Strategjik 4, Objektivin Specifik 4.3, të 2 aktivitete, rezulton të jenë *zbatuar plotësisht* konkretisht:

- Ndjekja dhe zbatimi i ecurisë së planit të integritetit: Rezultati i pritshëm për këtë objektiv specifik konsiston në monitorimin e zbatimit të planit, i cili për periudhën e raportimit rezulton të jetë i përmbushur dhe raporti i monitorimit do të publikohet publikuar në faqen zyrtare.
- Zhvillimi i procedurave në kuadër të sinjalizimit e veprimeve ose praktikave korruptive të punonjësve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: Për periudhën e raportimit nuk ka pasur procedura të zhvilluara, pasi nuk ka pasur sinjalizime për veprimeve ose praktikave korruptive të punonjësve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

KREU VI - KONKLUZIONE

Për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, periudha Janar – Qershor 2025, ka qenë një periudhë e cila ka patur zhvillime të rëndësishme dhe kryesorja është se për këtë periudhë nuk rezultojnë të ketë aktivitete të pazbatuara. Për të gjitha aktivitetet që janë në monitorim për këtë periudhë rezultojnë të ketë një ecuri të kënaqshme. Për tu theksuar është objektivi 2 i cili rezultojnë me një nivel realizimi të plotë, e ndjekur nga objektivi 1 dhe objektivi 4 të cilët kanë një progres të dukshëm nga periudha e mëparshme e raportimit. Megjithatë, duke u bazuar në objektivat e përcaktuara dhe të matura në Planin e Veprimit të Planit Strategjik, nga 44 aktivitete të planifikuara, për periudhën e raportimi 10 aktivitete rezultojnë se janë realizuar në periudha të mëparshme raportimi. Aktualisht për këtë periudhë, janar- qershor 2025, rezultojnë 21 aktivitete që janë realizuar plotësisht në masën 100%, 7 aktivitete janë realizuar pjesërisht, dhe 6 aktivitete nuk janë realizuar, për shkak se aktivitetet janë të lidhura me procese të cilat ILD mbetet në pritje të vënies në lëvizje të organeve apo subjekteve të tjerë.

Aktivitetet e përcaktuara, janë aktivitete të parashikuara, në objektivin 3 kryesisht, si më poshtë:

- Hartimi i dokumentit të termave të biznesit për sistemin e menaxhimit të çështjeve në ILD.
- Hartimi i dokumentit me specifikimet teknike për zhvillimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në ILD.
- Zhvillimi i sistemit dhe mirëmbajtja e tij.
- Hartimi i rregullores së roleve dhe përdorimit të sistemit.

Aktivitetet e paplotësuara janë ngushtësisht të lidhura me faktorë të jashtëm, pasi realizimi i tyre ka qenë i kushtëzuar nga hartimi dhe miratimi i udhërrëfyesit, i cili është një proces që udhëhiqet nga QTI, përfaqësuesit e grupit ndërinstitucional të punës, por edhe me kontributin e ekspertëve ndërkombëtarë. Pavarësisht se në grupin e punës përfaqësues të ILD-së kanë marrë pjesë rregullisht në takime dhe kanë përcjellë kontribut, ende nuk është miratuar edhe për këtë periudhë raportimi. Realizimi i këtij aktiviteti i hap rrugë edhe aktiviteteve të tjera të parashikuara në këtë objektiv, si ai i hartimit të dokumentit të termave të biznesit dhe hartimit të specifikimeve teknike për sistemin e menaxhimit të çështjeve, e më pas zhvillimit dhe mirëmbajtjes së sistemit elektronik. Jo vetëm miratimi i udhërrëfyesit shihet si një masë e cila nuk është e lidhur drejtpërdrejt me ILD-në por me faktorë të jashtëm, por edhe nevoja për financim për sistemin mbetet e ndërvarur nga miratimi i kërkesave buxhetore nga Ministria e Financave dhe Kuvendi, ku edhe për këtë periudhë raportimi mbeten pjesërisht të zbatuara.

Gjendje e pandryshueshme vihet re edhe me objektivin 1, për përtëritjen e kërkesës për ndryshimet ligjore apo propozime të reja, për të cilat nuk ka të komunikime apo njoftime nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, për shqyrtimin e tyre e për rrjedhojë ky aktivitet do të jetë i përcaktuar, për aq kohë sa realizimi i këtij aktiviteti mbetet kushtëzuar nga ndërmarrja e veprimeve nga një organ tjetër.

Ndryshe nga raportimi i periudhës së kaluar (korrik dhjetor 2024), Një nga aktivitetet me realizim në kohë sipas planifikimit, ka qenë realizimi i inspektimit sipas afatit të përcaktuar në

planin vjetor të inspektimeve. Për këtë periudhë raportimi 1 inspektim tematik ka përfunduar brenda afateve të përcaktuara në planin e inspektimit.